



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 215

Tiranë – E premte, 20 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 19.12.2024	
Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.....	24839



AKT NORMATIV
Nr.5, datë 19.12.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR.97/2023,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2024”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

Në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 2, 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2024 është:

Të ardhurat	515 390 milionë lekë;
Shpenzimet	572 670 milionë lekë;
Deficiti	57 280 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2024 është:

Të ardhurat	82 750 milionë lekë,
nga të cilat:	
- transferata e pakushtëzuar e përgjithshme	25 773 milionë lekë
- transferata e pakushtëzuar sektoriale	11 115 milionë lekë
- transferata sektoriale për pagat	1 500 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	44 362 milionë lekë;
Shpenzimet	82 750 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2024 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat, gjithsej	169 658 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet	134 059 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	35 599 milionë lekë;
Shpenzimet	169 658 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2024, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej	7 600 milionë lekë
nga të cilat:	
- kontributet	3 308 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 292 milionë lekë;
Shpenzimet	7 600 milionë lekë

3. Fondi për indeksimin e pensioneve është 1 693 milionë lekë dhe bonusi i pensionistëve, 9 874 milionë lekë. Ky fond ndahet midis skemave sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 3 700 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024.”.

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 1 shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk e tejkalon tavanin prej 12 000 milionë lekësh. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	13 757 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	459 221 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	42 412 milionë lekë.

Nga fondi i papërdorur i shpronësimeve në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, shuma prej 8 000 milionë lekësh derdhet në buxhet si e ardhur jotatimore.”.

Neni 4

Pika 2, e nenit 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth (minus) 12 547 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë vijon:

- Huamarrje afatgjatë e destinuar për projekte, me vlerë rreth 17 600 milionë lekë, nga të cilat nënha për pushtetin vendor 570 milionë lekë;

- Huamarrje në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare, me vlerë rreth 15 232 milionë lekë;

- Ripagesa të principalit, me vlerë rreth 45 379 milionë lekë.”.

Neni 5

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	553 000 milionë lekë;
- Fondi rezervë i buxhetit	3 250 milionë lekë;
- Kontingjenca për rritjen e pagave	11 000 milionë lekë;
- Kontingjenca për risqet e borxhit	5 420 milionë lekë.”.

2. Në pikën 6, shuma “100 milionë lekë” zëvendësohet me “40 milionë lekë”.

3. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Fondi deri në 600 milionë lekë në zërin “shpenzime kapitale” në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e

objekteve, pajisjeve dhe makinerive të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja për bashkitë, duke u financuar në vlerën e plotë në vitet e ardhshme buxhetore 2025-2026.

Fondi deri në 500 milionë lekë, akorduar në programin buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun” përdoret për skemën e mbështetjes me grante për investime në ferma në vlerën e plotë prej 1500 milionë lekësh, që financohet deri në vitin 2025.”.

4. Pas pikës 8 shtohen pikat 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14, me këtë përmbajtje:

“9. Krijohet llogaria e mbështetjes për pensionistët në Bankën e Shqipërisë. Llogaria përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave. Rregullat dhe procedurat e mbajtjes, përdorimit dhe raportimit të kësaj llogarie përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Për vitin 2024, fondi prej 6 300 milionë lekësh kalon në këtë llogari dhe përdoret sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Fondi prej 520 milionë lekësh, i detajuar për çdo institucion mbi fondet e parashikuara për këto institucione në tabelën 1 bashkëlidhur këtij ligji, përdoret për pagesën (këstin) e fundit të diferencës së pagës së magistratit nga 1 janari 2019 e në vazhdim, sipas arsyetimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.35, datë 22.11.2022. Detajimi i këtij fondi në artikuj buxhetorë bëhet nga vetë institucionet, referuar aneksit nr.9, bashkëlidhur këtij ligji, dhe ekzekutohet deri më 31 janar 2025.

Fondi prej 68 milionë lekësh, shtuar në shpenzimet korente të programit buxhetor “Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magistratit”, në masën 47 milionë lekë, dhe të programit buxhetor “Veprimtaria e komisionerit publik”, në masën 21 milionë lekë, përdoret për shlyerjen e detyrimeve për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2024 dhe për shpërblimin për vjetërsi në punë, si rrjedhojë e mbylljes së institucioneve: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë. Ekzekutimi i detyrimeve tatimore dhe i kontributeve të sigurimeve për pagesat e muajit dhjetor 2024 kryhet deri më 15 janar 2025.

11. Fondi prej 2 167 milionë lekësh përdoret për mbështetjen e shtresave në nevojë nga ministria



përgjegjëse për çështjet sociale, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

12. Fondi prej 2 000 milionë lekësh në programin “Planifikim, menaxhim, administrim” i ministrisë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik i transferohet shoqërisë “Albcontrol, sh.a.”, si mbështetje financiare në formën e huas.

13. Fondi prej 300 milionë lekësh në programin “Zhvillimi i sportit” i ministrisë përgjegjëse për sportin përdoret, si më poshtë vijon:

a) 200 milionë lekë për KOKSH-in për projektin “Ekipet sportive në shkolla” dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) 100 milionë lekë për organizimin e aktivitetit ndërkombëtar “*Giro d'Italia*”. Ngritja e grupit ndërinstitucional për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës për realizimin e tri tureve të para të “*Giro d'Italia*”, rregullat dhe procedurat për përdorimin e fondeve, si dhe mënyrën e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

14. Fondi prej 240 milionë lekësh në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përdoret për blerjen e selisë së misionit diplomatik të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në Bruksel, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi prej 1 577,4 milionë lekësh në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”, i Ministrisë së Financave, i transferohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të financuar projektet: “Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme” dhe “Regjistrimi fillestar i zonave kadastrale.”

5. Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen, zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

6. Bashkëlidhur ligjit shtohet aneksi nr.9, “Diferenca e pagës së magistratëve”, që përmendet në këtë nen dhe i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 6

Në pikën 4, të nenit 12, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, fondi i veçantë i institucioneve buxhetore ndryshohet dhe bëhet 520 milionë lekë.

2. Në fund të pikës shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 120 milionë lekësh përdoret si ndihmë e menjëhershme financiare për punonjësit e institucioneve buxhetore, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 7

Në pikën 1, të nenit 14, fondi rezervë bëhet 3 250 milionë lekë.

Neni 8

1. Në nenin 15 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

2. Në pikën 9, shifra “200 milionë lekë” zëvendësohet me “60 milionë lekë”.

Pas pikës 11 shtohen pikat 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

“12. Fondi prej 1 430 milionë lekësh shpërndahet ndërmjet bashkive në bazë të kriterëve të formulës së përdorur për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për vitin 2024. Kjo transfertë, në radhë të parë, përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe, pasi të jenë shlyer këto detyrime, përdoret për shpenzime të tjera. Kjo transfertë nuk përdoret për shpenzimet e rindërtimit.

13. Fondi prej 173 385 mijë lekësh akordohet si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për bashkitë për “Rivitalizimin e tregjeve tradicionale.”.

3. Tabela 3, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Tab.1

AN 2024 - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (në 000/LEK)

në 000/lekë

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	Presidenca	278,300	83,510	0	83,510	361,810
01120	Veprimtaria e Presidentit	278,300	83,510	0	83,510	361,810
2	Kuvendi	1,768,167	58,800	0	58,800	1,826,967
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	647,609	58,800	0	58,800	706,409
01120	Veprimtaria Ligjvënese	1,120,558	0	0	0	1,120,558
3	Kryeministria	779,900	30,000	0	30,000	809,900
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	779,900	30,000	0	30,000	809,900
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10,016,554	2,296,772	1,163,883	3,460,655	13,477,209
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	437,535	3,100	0	3,100	440,635
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	2,034,639	94,409	188,732	283,141	2,317,780
04240	Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes	928,400	1,890,000	0	1,890,000	2,818,400
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	5,839,780	210,863	975,151	1,186,014	7,025,794
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqësor	594,800	18,400	0	18,400	613,200
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	13,300	0	0	0	13,300
04230	Mbështetje për Peshkimin	168,100	80,000	0	80,000	248,100
6	Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë	7,405,929	47,813,974	12,097,902	59,911,876	67,317,805
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,307,101	10,080	0	10,080	1,317,181
04520	Transporti rrugor	4,042,522	34,763,890	3,397,470	38,161,360	42,203,882
04540	Transporti Detar	143,439	34,270	8,500	42,770	186,209
04550	Transporti Hekurudhor	512,955	931,310	4,262,393	5,193,703	5,706,658
04560	Transporti Ajror	30,430	1,878	0	1,878	32,308
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	0	0	0	0
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	535,751	11,289,982	1,659,539	12,949,521	13,485,272
04320	Mbështetje për Energjinë	113,156	475,955	2,770,000	3,245,955	3,359,111
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	266,081	190,175	0	190,175	456,256
04440	Mbështetje për Industrinë	370,231	73,314	0	73,314	443,545
06180	Planifikimi Urban	84,263	43,120	0	43,120	127,383
10	Ministria e Financave	10,245,240	950,220	562,690	1,512,910	11,758,150
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	903,504	85,600	562,000	647,600	1,551,104
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	537,188	0	0	0	537,188
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	2,171,044	640,000	0	640,000	2,811,044
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,704,747	96,400	0	96,400	2,801,147
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,794,847	123,220	690	123,910	3,918,757
01160	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	133,910	5,000	0	5,000	138,910
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	46,799,097	4,267,415	465,000	4,732,415	51,531,512
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	968,200	22,239	0	22,239	990,439
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	25,443,397	1,276,000	0	1,276,000	26,719,397
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	7,145,000	1,091,000	0	1,091,000	8,236,000
09450	Arsimi Universitar	11,550,000	1,460,000	70,000	1,530,000	13,080,000
09770	Fonde për Shkencën	796,400	274,080	395,000	669,080	1,465,480
08140	Zhvillimi i Sportit	896,100	144,096	0	144,096	1,040,196
12	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	46,636,147	2,563,598	621,600	3,185,198	49,821,345
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3,005,338	129,719	0	129,719	3,135,057
08220	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	903,999	127,803	2,700	130,503	1,034,502
08230	Arti dhe Kultura	1,446,672	1,106,635	1,000	1,107,635	2,554,307
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	109,867	11,900	0	11,900	121,767
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	338,436	89,350	55,500	144,850	483,286
04160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	367,304	13,500	0	13,500	380,804
10220	Sigurimi Shoqëror	34,695,939	0	0	0	34,695,939
10550	Tregu i Punës	2,380,350	134,212	0	134,212	2,514,562
04170	Inspektimi në Punë	227,005	10,000	0	10,000	237,005
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	2,530,195	376,079	562,400	938,479	3,468,674
06190	Strehimi	631,042	564,400	0	564,400	1,195,442
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	72,648,815	1,855,680	1,090,000	2,945,680	75,594,495
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	360,290	16,520	0	16,520	376,810
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	4,465,745	293,000	118,000	411,000	4,876,745
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytësor	34,587,512	1,279,190	972,000	2,251,190	36,838,702
07450	Sherbimet e Shëndetit Publik	3,608,849	253,800	0	253,800	3,862,649
10430	Perkujdesi Social	28,384,000	13,170	0	13,170	28,397,170
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,242,419	0	0	0	1,242,419
14	Ministria e Drejtësisë	13,356,330	998,763	0	998,763	14,355,093
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	644,836	526,020	0	526,020	1,170,856
03310	Ndihma Juridike	81,850	340	0	340	82,190
01120	Publikimet Zyrtare	52,224	4,103	0	4,103	56,327
01130	Mjekësia Ligjore	118,000	158,100	0	158,100	276,100



03440	Sistemi i Burgjeve	7,632,232	300,000	0	300,000	7,932,232
03350	Sherbimi i Permbartimit Gjyqësor	264,350	5,000	0	5,000	269,350
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	17,940	200	0	200	18,140
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	4,361,838	3,000	0	3,000	4,364,838
03490	Sherbimi i Proves	183,060	2,000	0	2,000	185,060
15	Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme	3,133,300	437,000	0	437,000	3,570,300
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	283,800	60,000	0	60,000	343,800
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,533,000	377,000	0	377,000	2,910,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	316,500	0	0	0	316,500
16	Ministria e Brendshme	26,913,234	927,200	122,972	1,050,172	27,963,406
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,541,832	36,995	1,900	38,895	1,580,727
03140	Policia e Shtetit	21,912,003	726,405	116,622	843,027	22,755,030
03150	Garda e Republikes	2,175,000	30,000	0	30,000	2,205,000
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	638,657	5,000	4,450	9,450	648,107
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	645,742	128,800	0	128,800	774,542
17	Ministria e Mbrojtjes	24,343,226	11,045,800	5,247,453	16,293,253	40,636,479
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,893,300	160,000	0	160,000	2,053,300
02120	Forcat e Luftimit	7,354,990	7,286,690	4,827,953	12,114,643	19,469,633
09430	Arsimi Ushtarak	821,000	441,000	0	441,000	1,262,000
02150	Mbeshtetja e Luftimit	6,290,936	1,065,000	0	1,065,000	7,355,936
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	1,518,000	370,000	0	370,000	1,888,000
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	5,200,000	0	0	0	5,200,000
10910	Emergjencat Civile	1,265,000	1,723,110	419,500	2,142,610	3,407,610
18	Sherbimi Informativ Shtetror	1,637,500	140,000	0	140,000	1,777,500
03520	Veprimtaria Informative Shtetore	1,637,500	140,000	0	140,000	1,777,500
19	Drejtoria e Radio Televizionit	670,000	23,000	0	23,000	693,000
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	279,000	0	0	0	279,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	200,000	23,000	0	23,000	223,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	91,000	0	0	0	91,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	100,000	0	0	0	100,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	265,700	130,000	0	130,000	395,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	265,700	130,000	0	130,000	395,700
22	Akademia e Shkences	453,380	10,000	0	10,000	463,380
01520	Veprimtaria Akademike	453,380	10,000	0	10,000	463,380
24	Kontrolli Larte i Shtetit	614,000	15,000	0	15,000	629,000
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	614,000	15,000	0	15,000	629,000
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,024,260	430,068	240,600	670,668	2,694,928
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	249,950	1,600	0	1,600	251,550
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	444,110	103,611	190,000	293,611	737,721
04260	Administrimi i Pyjeve	478,800	279,760	0	279,760	758,560
04760	Zhvillimi i Turizmit	835,400	15,350	600	15,950	851,350
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	16,000	29,747	50,000	79,747	95,747
28	Prokuroria e Pergjithshme	3,157,800	130,000	0	130,000	3,287,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3,157,800	130,000	0	130,000	3,287,800
29	Keshilli i Larte i Gjyqesor	4,436,459	338,000	0	338,000	4,774,459
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	340,059	14,383	0	14,383	354,442
01140	Mbeshtetje per teknologjinë e sistemit të drejtësisë	16,800	0	0	0	16,800
03310	Buxheti Gjyqësor	4,079,600	323,617	0	323,617	4,403,217
30	Gjykata Kushtetuese	230,800	35,000	1,500	36,500	267,300
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	230,800	35,000	1,500	36,500	267,300
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	82,469	5,000	0	5,000	87,469
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	82,469	5,000	0	5,000	87,469
35	Keshilli i Larte i Prokurorisë	204,083	10,000	0	10,000	214,083
01110	Veprimtaria e KLP	204,083	10,000	0	10,000	214,083
40	Partite Politike	355,800	0	0	0	355,800
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	345,600	0	0	0	345,600
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Vetereve me Status	2,200	0	0	0	2,200
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	1,041,563	268,000	0	268,000	1,309,563
03390	Veprimtaria e SPAK	1,041,563	268,000	0	268,000	1,309,563
50	Instituti Statistikës	777,500	93,000	110,000	203,000	980,500
01320	Veprimtaria Statistikore	777,500	93,000	110,000	203,000	980,500
55	Shkolla e Magjistratures	461,671	8,000	0	8,000	469,671
09820	Veprimtaria Arsimore	461,671	8,000	0	8,000	469,671
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	13,410,000	6,670,000	20,080,000	20,080,000
06210	Programe Zhvillimi	0	7,010,000	6,670,000	13,680,000	13,680,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	4,470,000	0	4,470,000	4,470,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	1,930,000	0	1,930,000	1,930,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	180,348	1,000	2,400	3,400	183,748
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	180,348	1,000	2,400	3,400	183,748
63	Institucionet e sistemit te drejtësisë	1,044,300	144,500	0	144,500	1,188,800



03320	Veprimtaria e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë	254,300	139,000	0	139,000	393,300
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	385,700	2,000	0	2,000	387,700
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	278,600	2,000	0	2,000	280,600
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	125,700	1,500	0	1,500	127,200
66	Avokati i Popullit	174,209	4,000	0	4,000	178,209
03320	Sherbimi i avokatise	174,209	4,000	0	4,000	178,209
67	Komisioneri për Mbikqyrjen e Sherbimit Civil	95,481	2,000	0	2,000	97,481
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	95,481	2,000	0	2,000	97,481
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	348,207	217,000	23,800	240,800	589,007
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	348,207	39,000	0	39,000	387,207
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	178,000	23,800	201,800	201,800
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	235,480	43,000	0	43,000	278,480
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	235,480	43,000	0	43,000	278,480
77	Autoriteti i Konkurences	111,500	1,000	0	1,000	112,500
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	111,500	1,000	0	1,000	112,500
82	Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit	17,400	1,000	0	1,000	18,400
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	17,400	1,000	0	1,000	18,400
87	Institucione të tjera Qeveritare	13,178,072	4,546,980	410,200	4,957,180	18,135,252
01320	Sherbime Qeveritare	300,000	450,000	0	450,000	750,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	91,784	1,000	0	1,000	92,784
05640	Administrimi i ujërave	125,683	10,000	193,000	203,000	328,683
03310	Sherbimi i Avokatise Shtetërore	325,914	2,000	0	2,000	327,914
01150	Sherbime të tjera	1,485,847	213,480	91,000	304,480	1,790,327
01140	e-Qeverisja	10,132,102	3,807,500	50,000	3,857,500	13,989,602
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	409,067	12,000	76,200	88,200	497,267
08610	Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët	165,954	50,000	0	50,000	215,954
08480	Mbështetje për Kultet Fetare	141,721	1,000	0	1,000	142,721
88	Mbështetje për Shoqërië Civile	129,525	1,000	0	1,000	130,525
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	129,525	1,000	0	1,000	130,525
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	141,700	18,000	0	18,000	159,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	141,700	18,000	0	18,000	159,700
90	Komisioni i Prokurimit Publik	93,898	20,300	0	20,300	114,198
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	93,898	20,300	0	20,300	114,198
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	70,150	1,000	0	1,000	71,150
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,150	1,000	0	1,000	71,150
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	56,160	1,000	0	1,000	57,160
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	56,160	1,000	0	1,000	57,160
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit	150,100	13,800	0	13,800	163,900
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	150,100	13,800	0	13,800	163,900
TOTALI		296,763,754	93,389,380	28,830,000	122,219,380	418,983,134



Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2024

Tab.3

Në mijë lekë

Nr.+B5:U 67	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2024	Shtesë me AN "Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme"	Transferrat e pakushtëzuara sektoriale															Totali
				Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Klubet shumësportëshe "Partizani dhe "Studenti"	Rritja e nivelit të pagave	Menaxhi mi i mbetjeve urbane	Menaxhi mi i mbetjeve urbane (shtuar nga Kuvendi)	Shtesë me AN "Financim i një projekti pilot zhvillim i"	Shtesë me AN "Rivitalizimi i tregjeve tradicionale"	
					Ndarë me formulë për personelin mësimor	Për stafin mbështetës													
1	Belsh	163,764	12,610	0	30,920	1,681	1,506	15,647	0	1,053	9,716	11,159	0	11,309	3,061				262,426
2	Berat	418,077	32,192	29,350	122,272	49,011	16,805	36,740	25,445	6,731	5,987	16,793	0	28,702	0				788,105
3	Bulqizë	350,683	27,003	0	61,934	12,175	0	21,996	0	16,540	35,454	14,986	0	16,182	0				556,953
4	Cërrik	199,627	15,371	4,927	52,285	6,661	6,787	17,432	0	2,580	2,231	17,963	0	13,998	6,632				346,493
5	Delvinë	86,948	6,695	0	23,534	6,126	2,195	15,783	0	3,016	4,185	11,159	0	11,645	0				171,287
6	Devoll	257,125	19,799	0	62,897	4,210	3,041	16,032	0	5,413	12,889	12,965	0	14,922	0				409,294
7	Dibër	550,281	42,372	25,807	143,809	36,145	11,497	29,303	0	9,807	17,378	15,890	0	31,559	0				913,847
8	Divjakë	282,939	21,786	0	62,422	1,838	1,582	15,037	0	1,057	9,624	34,001	0	19,375	0	15,000	128,000	29,993	622,656
9	Dropull	106,820	8,225	0	3,139	534	1,401	15,647	0	5,357	6,230	7,025	0	10,973	14,692				180,044
10	Durrës	1,211,509	93,287	24,376	221,249	61,876	23,078	58,109	0	3,819	29,703	51,232	0	43,910	240,791			29,937	2,092,878
11	Elbasan	959,175	73,857	30,500	257,699	71,066	40,781	40,220	22,632	14,477	21,622	16,793	0	50,800	18,263				1,617,885
12	Fier	837,900	64,519	22,809	196,399	50,848	13,439	39,455	27,589	4,810	10,542	66,917	0	51,976	0	20,000			1,407,204
13	Finiq	160,443	12,354	0	10,199	1,667	0	24,348	0	4,307	3,473	17,696	0	11,561	0				246,048
14	Fushë Arrëz	103,802	7,993	0	26,575	12,253	5,686	23,070	0	22,250	16,616	3,197	0	11,561	918				233,922
15	Gjirokastër	285,728	22,001	19,374	92,534	30,632	7,396	34,468	0	8,407	9,481	10,852	0	16,182	26,120			29,969	593,145
16	Gramsh	286,762	22,081	6,921	80,415	11,027	4,528	19,756	0	17,967	24,038	11,159	0	18,031	4,183				506,868
17	Has	191,982	14,783	7,214	39,640	4,210	3,614	17,600	0	17,840	1,972	12,714	0	13,157	0				324,726
18	Himarë	159,741	12,300	0	17,044	1,147	757	18,268	0	9,417	5,521	11,159	0	12,737	25,508				273,598
19	Kamëz	714,246	54,997	0	232,810	36,468	12,324	52,696	0	584	0	4,100	0	52,985	38,057				1,199,267
20	Kavajë	303,680	23,384	13,639	81,999	20,830	7,966	19,914	0	1,057	6,932	22,426	0	29,458	58,157				589,443
21	Këlcyrë	83,088	6,398	0	9,440	1,838	3,515	15,828	0	3,791	9,481	11,159	0	10,973	17,345				172,856
22	Klos	185,516	14,285	0	30,478	6,739	2,210	15,647	0	8,949	12,446	3,197	0	12,821	0				292,288
23	Kolonjë	160,068	12,325	10,419	37,401	6,739	5,027	18,535	0	18,131	11,040	19,847	0	10,889	0				310,420
24	Konispol	82,462	6,350	0	12,565	1,681	0	15,647	0	2,052	2,137	12,062	0	7,528	0				142,485
25	Korçë	598,629	46,095	23,461	165,468	53,299	23,132	35,124	0	18,075	8,094	51,897	0	29,878	0				1,053,152
26	Krujë	396,148	30,504	0	95,838	20,138	4,444	21,762	0	7,092	8,795	18,599	0	17,191	41,322				661,832
27	Kuçovë	226,489	17,440	0	68,984	22,667	8,372	17,023	2,811	1,772	2,490	14,986	0	16,938	0				399,974
28	Kukës	428,363	32,984	20,840	104,071	38,596	6,022	62,699	2,678	13,535	23,764	7,025	0	23,240	0				#REF!
29	Kurbini	315,779	24,315	0	95,956	27,691	18,574	18,416	0	3,428	4,787	23,330	0	16,770	10,713				559,759
30	Lezhë	459,562	35,387	9,971	114,248	33,695	20,538	43,195	0	9,435	6,402	26,039	0	29,206	8,264				795,942
31	Libohovë	54,837	4,223	0	6,969	1,681	1,412	15,647	0	3,206	7,855	3,206	0	5,091	5,408				109,536
32	Librazhd	368,755	28,394	0	78,858	12,175	3,841	16,652	0	10,494	29,792	14,986	0	20,047	3,673				587,668
33	Lushnje	566,894	43,651	9,917	159,266	37,905	13,944	17,448	0	2,059	9,066	53,703	0	35,004	0	20,000			968,857
34	Malësi Madhe	390,293	30,053	4,512	66,639	3,676	6,474	31,408	0	19,695	15,972	14,905	0	25,089	5,816				614,530



35	Maliq	400,661	30,851	0	90,212	4,744	12,521	15,647	0	6,879	10,729	45,360	0	22,820	0			640,425	
36	Mallakastër	210,177	16,184	0	67,213	18,992	8,169	17,385	0	3,468	8,860	14,986	0	13,830	0	10,000		389,262	
37	Mat	250,009	19,251	13,514	63,714	22,667	8,818	18,893	0	10,686	31,100	13,233	0	20,888	0			472,771	
38	Memaliaj	138,087	10,633	0	36,863	6,126	9,196	15,854	0	3,912	5,418	3,206	0	9,796	12,244			251,335	
39	Mirditë	265,539	20,447	23,463	55,109	20,624	9,316	24,401	0	18,069	23,163	17,060	0	19,207	0			496,397	
40	Patos	171,935	13,239	0	48,782	15,316	4,381	21,006	0	1,167	2,232	16,631	0	20,636	0	5,000		320,325	
41	Peqin	180,660	13,911	0	44,672	6,048	4,631	16,345	0	1,747	5,323	11,159	0	18,955	12,244			315,695	
42	Përmet	156,410	12,044	7,038	25,262	6,126	5,735	19,316	0	6,921	8,397	11,159	0	14,334	9,897			282,640	
43	Pogradec	483,138	37,202	0	153,598	9,111	11,703	21,627	0	19,330	25,199	12,062	0	35,172	0			808,141	
44	Polican	130,813	10,073	0	30,892	8,254	6,130	17,242	0	4,676	4,220	4,035	0	8,956	0			225,291	
45	Përrenjas	232,055	17,868	0	49,793	5,970	4,348	18,208	0	8,950	22,704	13,233	0	15,342	6,938			395,408	
46	Pukë	147,321	11,344	14,663	35,438	15,316	9,014	21,471	0	14,749	7,954	3,197	0	10,889	2,755		24,941	319,052	
47	Pustec	46,518	3,582	0	6,869	331	0	20,366	0	1,039	383	6,308	0	7,276	0			92,671	
48	Roskovec	148,096	11,403	0	34,597	2,985	2,879	15,647	0	1,167	4,875	7,928	0	13,746	0	4,000		247,324	
49	Rrogozhinë	195,957	15,089	0	36,474	7,273	2,920	15,037	0	1,722	0	11,159	0	12,149	16,631			314,411	
50	Sarandë	180,074	13,866	19,698	51,511	15,928	4,364	21,237	0	3,079	0	7,025	0	16,350	43,465			376,597	
51	Selenicë	228,819	17,619	0	31,564	5,436	11,404	17,717	0	5,479	3,384	17,475	0	11,813	0			350,709	
52	Shijak	195,877	15,083	0	43,296	7,965	3,686	20,210	0	1,057	59	7,025	0	12,401	21,630			328,288	
53	Shkodër	893,758	68,820	62,068	148,964	64,940	30,659	46,597	38,183	13,543	23,061	31,980	0	43,238	16,325		29,496	1,511,631	
54	Skrapar	163,289	12,573	11,880	40,491	13,800	10,974	21,515	0	10,236	15,567	16,343	0	12,989	0			329,659	
55	Tepelenë	114,721	8,834	7,214	37,788	9,802	4,354	16,213	0	6,128	7,585	3,205	0	10,805	16,325			242,973	
56	Tiranë	3,435,480	0	96,393	698,062	317,344	108,334	134,539	0	11,795	24,361	23,851	32,650	297,050	0			5,179,858	
57	Tropojë	272,814	21,007	0	49,242	14,090	4,404	19,358	0	17,536	10,731	3,717	0	14,250	0			427,148	
58	Dimal	182,931	14,086	0	54,053	534	1,919	15,783	0	1,039	4,638	20,927	0	14,418	0			310,328	
59	Vau i Dejës	299,147	23,035	9,350	45,721	1,069	2,899	15,037	20,363	7,906	7,026	13,868	0	21,224	2,245			468,889	
60	Vlorë	761,086	58,604	27,628	235,137	80,254	38,948	48,566	0	7,022	3,344	44,886	0	37,440	0		29,049	1,371,965	
61	Vorë	173,293	13,344	0	49,628	2,985	6,068	15,037	0	1,054	601	11,159	0	22,148	24,589			319,905	
Totali		22,006,781	1,430,000	556,946	5,130,902	1,372,957	609,662	1,546,805	139,700	468,559	646,628	1,037,307	32,650	1,489,808	714,211	74,000	128,000	173,385	37,558,302

Shënim: Bashkia Tiranë nuk përfshihet në shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme sepse ka potencial të lartë fiskal për të mbledhur të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore.



TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2024

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2024

ne milion leke (in million lek)

Nr.	EMËRTIMI	Akti Normativ 2024	Ne % te PBB	ITEMS
I.	TOTALI TE ARDHURAVE	714,068	29.3%	TOTAL REVENUE
	Te ardhura nga ndihmat	13,757	0.6%	Grants
	<i>Nga te cilat: mbeshetje buxhetore</i>	<i>1,957</i>	<i>0.1%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga te cilat: projekte te destinuar per investime</i>	<i>11,800</i>	<i>0.5%</i>	
	Te ardhura tatimore	657,899	27.0%	Tax Revenue
	Nga Tatimet dhe Doganat	459,221	18.9%	From tax offices and customs
	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	213,806	8.8%	V.A.T
	Tatimi mbi Fitimin	59,719	2.5%	Profit Tax
	Akcizat	64,375	2.6%	Excise Tax
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	64,438	2.6%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe te tjera	47,555	2.0%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	9,328	0.4%	Customs Duties
	Te ardhura nga Pushteti Vendor	39,314	1.6%	Local Taxes
	Taksa Lokale	32,003	1.3%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	7,311	0.3%	Property Tax
	Te ardhurat nga Fondet Speciale	159,364	6.5%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shoqeror	137,367	5.6%	Social Insurance
	Sigurimi Shendetesor	21,091	0.9%	Health insurance
	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	905	0.0%	Revenues for owners' in value-compensation
II.	Te ardhura Jotatimore	42,412	1.7%	Nontax Revenue
	Transferta e fitimit nga Banka e Shqiperise	0	0.0%	Profit transfer from BoA
	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	14,300	0.6%	Income from budgetary institutions
	Dividenti	300	0.0%	Divident
	Tarifat e Sherbimeve	3,700	0.2%	Services Fees
	Te tjera	8,212	0.3%	Others
	Rezultati financiar i ISSH	7,900	0.3%	
	Te ardhura nga Shpronisimet	8,000	0.3%	
I.	TOTALI I SHPENZIMEVE	771,348	31.7%	TOTAL EXPENDITURE
	Shpenzime Korrente	629,059	25.8%	Current Expenditures
	Personeli	118,455	4.9%	Personnel expenditures
	Paga	91,123	3.7%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	14,812	0.6%	Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave, nga e cila:	520	0.0%	Bonus fund
	<i>Sherpbilimi i punonjeseve mbeshtetes te Administrates Publike</i>	<i>120</i>	<i>0.0%</i>	
	Politika te reja pagash	11,000	0.5%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	1,000	0.0%	Higher Education from its own revenues
	Interesat	60,328	2.5%	Interest
	Te Brendshme	33,344	1.4%	Domestic
	Te Huaja	21,564	0.9%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	5,420	0.2%	Contingency for debt related risks
	Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:	82,644	3.4%	Operational & Maintenance of which:
	<i>Te qeverisjes qendrore</i>	<i>79,044</i>	<i>3.2%</i>	<i>Central government</i>
	<i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i>	<i>1,000</i>	<i>0.0%</i>	<i>from revenues of Higher Education System</i>
	<i>Te tjera jashte limitit</i>	<i>2,600</i>	<i>0.1%</i>	<i>from Exceptional Revenues</i>
	Subvencionet	1,724	0.1%	Subsidies
	Shpenzime per Fondet Speciale	251,877	10.3%	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	177,258	7.3%	Social insurance
	Politika te reja pensionesh	1,693	0.1%	Contingency for new pension policies
	Bonusi i Pensionisteve	9,874	0.4%	Pensioners' Bonus
	Sigurime Shendetesore	58,052	2.4%	Health insurance
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	5,000	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
	Shpenzime per Buxhetin Vendor	82,750	3.4%	Local Budget expenditure
	Transferrat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	38,388	1.6%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme</i>	<i>25,773</i>	<i>1.1%</i>	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specifik)</i>	<i>11,115</i>	<i>0.5%</i>	<i>Specific Grant</i>
	<i>Transferte sektoriale per pagat</i>	<i>1,500</i>	<i>0.1%</i>	<i>Specific Grant for wages</i>
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	39,314	1.6%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa të ndara	1,478	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jo-tatimore)	3,000	0.1%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor dhe te tjera te mbartura	570	0.0%	Local foreign financing
	Shpenzime te tjera	31,281	1.3%	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	764	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	24,949	1.0%	Social assistance and disability
	Mbeshetje financiare per shtresat ne nevojë	2,167	0.1%	
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,200	0.0%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,200	0.1%	Birth Bonus



II.	Fondi Rezerve	3,770	0.2%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve	3,250	0.1%	Reserve Fund
	Kontigjence per diferençen e pages se Magjistrateve	520		Contingency for deficit financing
III.	Shpenzime Kapitale	132,219	5.4%	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	93,389	3.8%	Domestic financing
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0.0%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi Huaaj	28,830	1.2%	Foreign financing
	nga të cilat: Energjia	2,000	0.1%	from which: Energy
	Fondi i Rindertimit	9,000	0.4%	Reconstruction Fund
IV	Transferte per Llogarine e Fondit te Pensioneve ne BSH	6,300	0.3%	
	DEFIÇITI	-57,280	-2.4%	Cash Balance
	FINANCIMI DEFIÇITIT	57,280	2.4%	Financing (Cash)
	Brendshem	69,827	2.9%	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi			Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	50,000	2.1%	Domestic borrowing
	Te tjera	19,827	0.8%	Other
	I Huaaj	-12,547	-0.5%	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	17,600	0.7%	Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-45,379	-1.9%	Repayments
	Mbeshtetje buxhetore	15,232	0.6%	Budget support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	2,434,311	100.0%	Gross Domestic Product (GDP)

ANEKS NR.9 - DIFERENCA E PAGËS SË MAGJISTRATËVE

000/lekë

Nr	Institucioni	Shpenzime korente
1	Prokuroria e Përgjithshme	300,000
2	Këshilli i Lartë Gjyqësor	91,000
3	Gjykata Kushtetuese	30,000
4	SPAK	0
5	Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (3109/1 date 07.11.2023)	0
6	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	68,000
7	Kolegji i Posaçëm i Apelit	20,000
8	Komisioneri Publik	3,000
9	Këshilli i Lartë i Prokurorise	0
10	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5,500
11	Avokati i Popullit	0
12	Shkolla e Magjistraturës	2,500
TOTAL		520,000

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

